

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Nënshkruar me datë 10/12/2021

Ndëmjat

- Z. Simone Suatti , lindur me dt 03/05/1978, ne Marino Itali dhe banues ne Durrës Lgj. 13, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit Nr AX8200222 (ne vijim "Shitesi"), ose "Pala" ose bashkarisht "Palët";
- dhe*
- Znj. Sonila Deliallisi, lindur me dt 25/01/1988, ne Berat dhe banues ne Durres Lgj.1, madhor, me zotësi te plotë për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit Nr I85125053G (në vijim "Blerësi"), ose "Pala" ose bashkarisht "Palët";

Të gjitha palët zotërojnë aftësi të plotë për të vepruar, me vullnet te lirë, duke un përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, pranojnë të lidhin këtë kontratë për shitjen e kuotave sipas kushteve të mëposhtme.

Duke pasur parasysh se

Palët zotërojnë Simone Suatti 100% të kapitalit themeltar te shoqërisë "A.G.E" Sh.p.k. e regjistruar në Regjistrin Tregtar (QKR) me numër unik identifikimi (NUIS) M12211501B (në vijim "Shoqëria").

Palet bien dakort për sa mëposhtë vijon:

NENI 1

Kushtet paraprake të sipërpërmendura janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

NENI 2


Shitësi i shtet me të drejta pronësie te plota Bleresit, i cili siç është përcaktuar më sipër pranon dhe blen 49% te kapitalit themeltar, me çmimin e barabartë me 49,000 (dyzet e nentëmijë) LEK, shumë që pala blerëse deklaron se i ka paguar palës shitëse e cila pranon se i ka marrë nga pala blerëse mëparë.

NENI 3

Z. Simone Suatti deklaron se këto kuota janë në pronësi të tij të plotë dhe ekskluzive, nuk janë objekt çështje gjyqësore në zhvillim e sipër dhe gjithashtu janë të lira nga çfarëdo lloj pengu.

NENI 4

Me ane të kësaj kontrate Blerësi bëhet pronar i pjesëve të blera duke fituar njekohësisht të gjitha të drejtat , por duke i lene Shitësit të gjitha detyrimet e lidhura të kuotave dhe shoqërisë nga rnomenti i regjistrimit të shoqërisë. Administrimi i zakondëshem dhe i jashtëzakonsëm i shoqërisë i takon administratorit ose palës që ka kuota më të larta.



NENI 5


Kjo kontratë përfshin tërësisht marrëdhëniet midis palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme që janë të lidhura me këtë objekt. Ndryshime të mundëshme ose kufizime të kësaj kontrate mund t'i bëhen vetëm me shkrim, të nënshkruhen nga të gjitha palët dhe t'i bashkëngjiten asaj.

NENI 6

Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe dhe në 3 (tre) kopje me të njëjtën vlerë ligjore, të gjitha të nëshkruara nga palët dhe rregullohet nga Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

SHITËSI

SIMONE SUATTI



BLERËSI

SONILA DELIALLISI

